

€679

per person

SKANDINAVIA Nisje: • 8 Tetor

DESTINACIONI

**Oslo / Kopenhagen /
Malmo / Gethenburg /**

PERIUDHA

Vjeshtë '2026

KOHËZGJATJA

5 Ditë

TRANSPORTI

Me Avion

PËRMBLEDHJE



SHTATOR 2026



Nisje 8 Tetor - Kthim 12 Tetor

- 5 Ditë / 4 Netë
- Çmimi: **679€**
-  Nisja: 19:40 (Tiranë) → 22:25 (Malmo)
-  Kthimi: 21:30 (Oslo) → 00:40 (Tiranë)

1

MALMO

DITË

Takimi në aeroportin e Tiranës me shoqëruesin e grupit rreth 2 orë përpara nisjes së fluturimit. Kryerja e procedurave të check-in dhe nisja me fluturim direkt Tiranë – Malmö (kohëzgjatja rreth 3 orë e 5 minuta).

Mbërritja në Malmö dhe, pas përfundimit të procedurave doganore, transferimi drejt hotelit.

Akomodimi në hotel në zonën Malmö

2

KOPENHAGEN

DITË

Mëngjesi në hotel.

Vazhdimi i udhëtimit drejt Danimarkës për në **Kopenhagen**, kryeqytetin elegant të Danimarkës. nëpërmjet urës së Øresundit, një nga veprat më mbresëlënëse inxhinierike që lidh Danimarkën me Suedinë.

Mbërritja dhe fillimi i vizitës panoramike të monumenteve kryesore të qytetit. Gjatë turit do të vizitohen:

- **Katedralja e Kopenhagenit** dhe zona përreth ku ndodhet edhe **Universiteti i Kopenhagenit**, si dhe **Rundetårn (Kulla e Rumbullakët)**
- **Rådhuspladsen**, sheshi kryesor i qytetit ku ndodhet **Bashkia**
- **Pallati Christiansborg**, selia e parlamentit danez dhe institucioneve shtetërore
- **Pallati Rosenborg**, i rrethuar nga kopshte mbretërore
- **Sheshi Amalienborg**, ku ndodhet rezidenca aktuale e familjes mbretërore daneze
- **Kisha e Frederikut (Frederik's Church)**, e njohur si Kisha e Mermerit
- **Shatërvani Gefion**, një nga monumentet më të njohura të qytetit
- **Sirena e Vogël**, simboli ikonë i Kopenhagenit, frymëzuar nga përralla e Hans Christian Andersen

Pas vizites në Kopenhagen kthimi në mbrëmje për në hotel në Malmö

Mëngjesi në hotel.

Fillimi i vizitës së Malmos, nga qendra historike e qytetit. Gjatë qëndrimit do të vizitohen **Stortorget dhe Lilla Torg**, sheshet më të njohura me ndërtesa karakteristike dhe atmosferë tipike nordike. Vazhdimi me një shëtitje pranë **Kalasë Malmöhus** (vizitë e jashtme) dhe në parqet përreth si **Kungsparken**, ideale për relaks dhe foto.

Më pas, vizitë panoramike drejt zonës moderne të qytetit ku ndodhet **Turning Torso**, simboli arkitektonik i Malmö-s. Sipas kohës në dispozicion, mundësi për shëtitje buzë detit në **Ribersborg Beach** ose kohë e lirë për shopping në qendër të qytetit.

Vazhdimi i udhëtimit për në Gothenburg

Gjate udhëtimit, vizitë e shkurtër panoramike në Helsingborg, një nga qytetet bregdetare më të vjetra dhe më tërheqëse të Suedisë. Gjatë ndalesës në Helsingborg do të shijoni një shëtitje në qendrën historike, do të vizitoni kullën e famshme Kärnan, sheshin Stortorget dhe zonën e bukur buzë detit me pamje drejt Danimarkës. Kohë e lirë për foto, një kafe ose një shëtitje të shkurtër në qendrën e qytetit.

Mbërritja në Gothenburg dhe akomodimi në hotel.

Fjetia në Gothenburg

Mëngjesi në hotel.

Gothenburg, një nga qytetet më të rëndësishme dhe më të gjalla të Suedisë. Fillimi i vizitës panoramike në monumentet kryesore të qytetit. Vizita nis në **Sheshin Gustav Adolf**, ku ndodhet **Bashkia e qytetit**, një nga pikat më të rëndësishme historike. Vazhdimi drejt **qytetit të vjetër (Stortorget)** dhe **Katedrales Domkyrkan**, simbol i trashëgimisë fetare dhe arkitekturore.

Shëtitje në **Kungsparken**, një nga parqet më të bukura të qytetit, ideal për relaks dhe foto. Më pas, vizitë në lagjen historike **Haga**, e ndërtuar nga holandezët, e njohur për rrugicat piktoreske, dyqanet artizanale dhe kafenetë tradicionale.

Vazhdimi i programit drejt **Götaplatsen**, një nga sheshet më të rëndësishme kulturore të Gothenburg, ku ndodhen institucione si muze dhe teatro të njohur.

Në fund, kohë e lirë për shopping në **Nordstan**, një nga qendrat tregtare më të mëdha në Skandinavi.

Pas vizitës në Gothenburg nisja për në Oslo.

Udhëtimi zgjat rreth 3-4 orë, gjatë të cilit do të shijohen pamje të bukura natyrore.

Mbërritja dhe akomodimi në Oslo.

Mëngjesi në hotel.

Fillimi i vizitës së Oslos, kryeqytetit elegant të Norvegjisë, i rrethuar nga natyra dhe i pasur me histori dhe kulturë. Vizita nis me **Kështjellën Akershus** (vizitë e jashtme), një fortesë mesjetare me pamje mbresëlënëse mbi fjordin e Oslos. Vazhdimi drejt **Bashkisë së qytetit (Rådhuset)**, ku çdo vit zhvillohet ceremonia e ndarjes së Çmimit Nobel për Paqen.

Shëtitje përgjatë bulevardit kryesor **Karl Johan Gate**, zemra e qytetit, ku do të shohim **Teatrin Kombëtar, Parlamentin Norvegjez (Stortinget)** dhe **Pallatin Mbretëror**, rezidenca zyrtare e monarkut norvegjez (vizitë e jashtme).

Vazhdimi i programit me një nga atraksionet më të veçanta të qytetit, **Parku i Skulpturave Gustav Vigeland** brenda **Frogner Park**, një hapësirë e jashtëzakonshme me mbi 200 skulptura që pasqyrojnë ciklin e jetës njerëzore. Më pas, nisja drejt zonës së **Holmenkollen**, e njohur për pistën e famshme të skive dhe panoramën spektakolare që ofron mbi qytetin dhe fjordin.

Pas vizites së Oslos transferimi në mbrëmje për në Aeroport

Fluturimi Direkt Oslo – Tiranë (3 orë : 05 min)

ÇFARË PËRFSHIHET

✓ PËRFSHIHET

- ✓ Udhëtimi vajtje-ardhje me avion Tiranë – Malmo dhe Oslo – Tiranë Transfertat dhe Shëtitjet me autobus sipas programit. Akomodimi në hotel 4 Yje në Malmo për dy netë, në Gotheburg për 1 natë, në Oslo për 1 natë. Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit. Guida në gjuhën shqipe gjatë Turit. Lejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa 40cm x 30cm x 20cm deri në 10 kg. (Kujdes – Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

× NUK PËRFSHIHET

- × Drekat dhe Darkat. Hyrjet në monumente dhe muzeume. Taksa lokale 5 eur personi për natë (e detyrueshme dhe paguhet në zyrë bashkë me pagesën e turit)

ENDTAKIMI I NISJES

- Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT

- Fëmijët në moshën 2 – 11.99 vjeç përfitojnë 50€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn në fuqi vetëm nëse fëmijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

DOGANA

- 1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj
- 2) Nuk duhet të keni kaluar në 6 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

INFORMACIONE

- Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 30% mbi çmimin për person.
 - Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
 - Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do të jetë standart, atëherë do të jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
 - Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadenca e mjetit identifikues, etj.
 - Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
 - Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
 - Cmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.
- Për cdo ndryshim në lidhje me këto aktivitete, klienti lajmërohet përpara kryerjes së shërbimit.
- Kujdesi ndaj sendeve personale gjatë qëndrimit në aeroplan, autobuz, traget, është përgjegjësi individuale e klientit dhe jo e Operatorit

DESTINACIONI	Olso / Kopenhagen / Malmo / Gethenburg /
TRANSPORTI	Me Avion
ÇMIMI	€679.00 / person
ZBRITJE FËMIJË	99% (€7.50)
GJENERUAR	26/08/2026 14:39